



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 576 Prot

Shkodër me 23.10 2024

V E N D I M

Nr. 23, Datë 22.10.2024

“PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR FINANCIM NGA FONDI SOCIAL, PËR NGRITJEN APO VAZHDIMËSINË E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2025”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.10.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Specialisti i Çështjeve Sociale “Për miratimin e kërkesave për financim nga fondi social, për ngritjen apo vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara me marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse për Këshillin e Qarkut Shkodër për vitin 2025”, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 2, të nenit 48 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 224, datë 09.04.2024 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” pasi u diskutua në mbledhjen e kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër dt.18.10.2024, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u *miratua me 13 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim;*

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për financim nga fondi social për ngritjen apo vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara me marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse dhe



përkatësisht;

- Financim për Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa”, për vazhdimësinë e shërbimeve për vitin pasardhës, sipas kërkesës për financim nga fondi social të paraqitur nga kjo organizatë në shumën **7,133,733 lekë**.
- b. Financim për Qëndrën Ditore “Buzëqeshja e Motër Lezes”, Madonnina della Grappa”, për vazhdimësinë e shërbimeve për vitin pasardhës, sipas kërkesës për financim nga fondi social të paraqitur nga kjo organizatë në shumën **9,288,404 lekë**.
- c. Financim për Struktura Rezidenciale “Don Carlo Zaccaro”, Madonnina della Grappa”, për fillimin e shërbimeve për vitin pasardhës, sipas kërkesës për financim nga fondi social të paraqitur nga kjo organizatë në shumën **25,843,864 lekë**.
- d. Financim për Shtëpi-Familje ‘Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative” për vazhdimësinë e shërbimeve për vitin pasardhës, sipas kërkesës për financim nga fondi social të paraqitur nga kjo organizatë në shumën **13,457,774 lekë**.
- e. Financim për Projektin Për Qëndrat Ditore “Projekti Shpresa” për ngritjen e shërbimeve për vitin pasardhës, sipas kërkesës për financim nga fondi social të paraqitur nga kjo organizatë në shumën **9,996,000 lekë**.
- f. Financim për Projektin “Përfshirje sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara nga The Door Albania” për ngritjen e shërbimeve për vitin pasardhës, sipas kërkesës për financim nga fondi social, të paraqitur nga kjo organizatë në shumën **5,521,200 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

